REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. Prot **Bilisht, më___/___/ 2025**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 17 Datë 21.02.2025

"PËR
MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT, NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË TË ARDHURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJNË INDIVIDËT/FAMILJET PËR T'U TRAJTUAR ME PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, , nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, vendimit Nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", vendimit Nr. 301, datë 15.4.2020, të Këshillit të Ministrave "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", si dhe në vijim të vendimit Nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", të ndryshuar :

PROPOZOJ:

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit për subvencionimin e individëve/familjeve që përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave të familjeve, sipas strukturës së apartamentit që ato përfitojnë, referuar të dhënave të institucioneve përkatëse, sipas Aneksit nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Individi/familja paraqet kërkesën për të përfituar (Faza 1) nga ky program përmes portalit qeveritar "e-Albania", brenda 45 ditëve kalendarike nga njoftimi publik për hapjen e thirrjes, duke zgjedhur shërbimin "Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social.
4. Individët apo familjet që kanë kaluar fazën e parë, brenda 30 ditëve kalendarike duhet të

depozitojnë pranë zyrave të Bashkisë Devoll, formularin e strehimit të plotësuar elektronikisht në portalin e-Albania, shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në Aneksin nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Dokumentacion i vlefshëm do të konsiderohen dokumentet që janë lëshuar nga institucionet kompetente jo më herët se 3 (tre) muajt e fundit. Individi/familja që ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, ose në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin në fuqi për strehimin social dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, i hiqet e drejta për të përfituar.

6. Ngarkohet kryetari i Bashkisë, për nxjerrjen e akteve të nevojshme në funksion të realizimit të programit "Subvencionimi i interesave të kredisë" dhe qëllimit të këtij vendimi.

7. Ngarkohen, Drejtoria Juridike, si dhe Komisioni i Strehimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR I BASHKISË

EDUARD DURO

Konceptoi: Specialiste për administrimin e nevojave për strehim
Linda Laçi
Konfirmoi: Përgjegjës i sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit
Zerina Sinani

Konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

Aneksi nr. 1 - Formula e Pikëzimit për programin e strehimit social "Subvencionimi i interesave të kredisë"

	SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT "SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË"	Pikët
1.1	**KUSHTET E STREHIMIT**	**25**
I.	Nuk disponon banesë në pronësi	9
II.	Banesa në rrezik shembje	3
III.	Banojnë në banesa të mbi populluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	3
IV.	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i Fatkeqësive natyrore;	3
V.	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	4
VI.	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat I investimeve publike;	3
1.2	**KUSHTET FAMILJARE**	**25**
I.	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna;	6
II.	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t`u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	2
III.	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	5
IV.	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	6
V.	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	6
1.3	**KUSHTET SOCIALE**	**25**
I.	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave	4
II.	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	4
III.	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve.	1

IV.	Emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese;	2
V.	Familjet e policëve të rënë në detyrë	2
VI.	Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH Punonjës i repartit RENEA Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	4
VII.	Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit.	3
VIII.	Anëtar e komunitetit Rom dhe Egjiptian	3
IX.	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikime vetë Kodit Të Drejtësisë Penale për të mitur,	1
X.	Individë që i përket komunitetit LGBTI,	1
1.4	**KUSHTET EKONOMIKE**	**25**
i.	Familje me të ardhura mesatare që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 për qind e të ardhurave mesatare;	9
ii.	Familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 për qind e të ardhurave mesat are	9
iii.	familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare	7
iv.	Familje pa të ardhura	0
	TOTALI PIKË	**100**

Në total sistemi i pikëzimit përmban 100 pikë, ku çdo kriter përmban 25 pikë.

Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave grupohen familjet, sipas të të ardhurave përcaktohen bazuar në të dhënat e përditësuara të Instituti të Statistikave (INSTAT) sipas nenit 2, pikës 45 të ligjit 22/2018 "Për strehimin Social" i ndryshuar.

Aneksi 2 - Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potencialë sipas tabelës:

Struktura familjare	Struktura apartamentit	Niveli Mesatar i të ardhurave në lekë	Të ardhurat maksimale (120% të të ardhurave mesatare) në lekë
1	Garsoniere	64 760	77 712
2	1+1	80 578	96 693
3	2+1	95 022	114 026
4	3+1	104 825	125 790
5+	3+1	102 351	122 821

Aneksi nr. 3 - Lista e dokumentacionit

DOKUMENTACIONI PËR TË PËRFITUAR SUBVENCIONIM TE INTERESAVE TË KREDISE

1. Për të dhëna personale të aplikantit:
a. Fotokopje të kartës së identitetit së aplikantit.
b.Çertifikaten e lindjes së aplikantit
c. Vërtetim për vendbanimin (të Administratori i lagjes /Njësisë Administrative)

2. Për vërtetimin e kushteve të strehimit sipas shkronjës "a" të nenit 16, të Ligjit nr, 22/2018 "|Për strehimin social";
a. Vërtetimin negative nga ASHK (Agjencia Shteterore e Kadastres), që në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes ,nuk figuron ,në të gjithë territorin e Shqipërisë, pronë e regjistruar ose në proces regjistrimi ose vërtetimin për një pronë që është nën normat e banimit.
b.aktverifikim nga bashkia për :
-banesat në rrezik shembjeje;
-rastet kur familja ka mbetur e pastrehe ,si rezultat i fatkeqësive natyrore ;
- banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit :
- vendim i gjykatës për familjet që kanë humbur banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
- aktverifikimi nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

3. Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës "b", të nenit 16 të ligjit 22/2018 "|Për strehimin social";

a. Çertifikatë familjare;
b. Vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

4. Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social";
-vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;
-dokumenti që vërteton që ke mbetur i pastrehe si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;
-urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar

4. Për vërtetimin e kushteve ekonomike:
a. Vërtetim i të ardhurave neto të familjes, për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, në moshë madhore që janë në marrëdhënie pune;
b. Dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
c. Vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes të bashkisë, për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
d.Vertetimin per masen e pensionit per personat e familjes qe jane ne pension
e.Vertetimin nga e-albania per personat qe jane punekerkues te papune.
f.Vertetimin e fitimit te te ardhurave nga biznesi per personat e vetpunesuar te vitit te fundit.
h.Vërtetim nga drejtoria e taksave të bashkisë, që aplikuesi nuk ka detyrime për taksat dhe tarifat vendore.
l.Numrin e telefonit per personin e kontaktit.

Shënim; Dokumentat e sipërcituar të dorëzohen pranë protokollit të Bashkisë brenda datës

15.04.2025

Shënim: Shqyrtimi i dokumentacionit realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditë kalendarike nga përfundimi i afatit të dorëzimit nga drejtoria përgjegjëse e cila vë në dispozicion të Komisionit të Strehimit për vlerësim të mëtejshëm, vetëm praktikat e sakta që përmbajnë formularët e aplikimit dhe dokumentacionin e individëve apo familjeve që kanë aplikuar për këtë program strehimi dhe që në bazë të kritereve të vendosura kualifikohen si të vlefshëm.

**** Për familjet të cilat kanë lidhur martesë me shtetas të huaj ose individë të cilët kanë vendlindjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pranohet vetëm dokumentacioni i siguruar nga Institucionet e kësaj të fundit.***